VENDIM
Nr. 141, datë 22.11.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "GJOKA KONSTRUKSION - ENERGJI" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET "LENIE", "SHALES" DHE "STRELCË"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa "a", nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a" dhe neneve 13 dhe 14, pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 22.11.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Gjoka Konstruksion - Energji" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Gjoka Konstruksion - Energji" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Gjoka Konstruksion - Energji" sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Lenie" me fuqi 0,8 Mw, "Shales" me fuqi 1.08 Mw dhe "Strelcë" me fuqi 1,174 Mw.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti